



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 288/2\_prot.

Tiranë, më 19.05.2019

**VENDIM**

**Nr.49, datë 29.05.2019**

**PËR  
PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT  
TË ZBATIMIT TË VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 89, DATË 13.11.2018, NË  
INSTITUCIONIN E BASHKISË MIRDITË**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Mbikëqyrjes dhe Inspektimit dhe Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit Nr. 89, datë 13.11.2018 të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në njësinë e vetëqeverisjes vendore, Bashkia Mirditë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”,

**KONSTATOVA SE:**

Bazuar në Urdhrin *nr. 28 (295 prot.)*, datë *18.02.2019*, “Për fillimin e procesit të verifikimit të zbatimit të vendimeve paralajmëruese të Komisionerit, pas përfundimit të afatit të vendosur për rregullimin e ligjshmërisë”, Komisioneri ka nisur procesin e mbikëqyrjes në vazhdim, që ka të bëjë me ekzekutimin e vendimit paralajmërues nr. 89, datë 13.11.2018, pas përfundimit të afatit të caktuar nga Komisioneri për rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në Bashkinë Mirditë.

Ky proces u realizua nëpërmjet verifikimit të situatës në institucion, në përfundim të të cilit grupi i punës përpiloi edhe një Akt – Konstatimi, nga përmbajtja e të cilit vërej se:

Në mbështetje të nenit 11, pika 1, si dhe të nenit 14, pikat 1 e 2 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe në zbatim të planit vjetor të punës, miratuar me vendimin nr. 1, datë 03.01.2018, nëpërmjet Vendimit nr. 68, datë 22.06.2018, “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në Bashkinë Mirditë”, Komisioneri ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në njësinë e vetëqeverisjes vendore, Bashkia Mirditë.

Pas përfundimit të mbikëqyrjes, Komisioneri ka dërguar pranë Bashkisë Mirditë raportin përfundimtar dhe vendimin paralajmërues me nr. 89, datë 13.11.2018, për rregullimin e ligjshmërisë, duke i lënë institucionit detyra për përmirësimin e situatës, si dhe një afat prej 60 ditësh për zbatimin e tyre.

Mbështetur në gjetjet e specifikuar në këtë raport dhe në detyrat e lëna për Bashkinë Mirditë, në përmbajtjen e vendimit paralajmërues për rregullimin e ligjshmërisë, si dhe duke verifikuar në subjekt veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse, konstatoj se situata aktuale e administrimit të shërbimit civil, e specifikuar sipas radhës së detyrave në vendim, rezulton si më poshtë:

Në vendimin paralajmërues, konkretisht në pikën 2 të tij, është lënë detyrë që të konstatohet pavlefshmëria absolute e akteve të emërimit për punonjësit:

- ✓ \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, specialiste e auditit të brendshëm,
- ✓ \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, specialiste e aseteve publike,
- ✓ \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, Inspektore Monitorim Tregu,
- ✓ \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, Specialiste Intergrimi në BE,

Bazuar në aktin e konstatimit dhe dokumentet e administruara nga grupi i punës, vërej se punonjësit janë njoftuar me shkrim edhe nëpërmjet postës elektronike për ndërprerjen e marrëdhënieve financiare, duke filluar nga dt.16.01.2019. Po në këtë datë, janë shpallur vendet vakante dhe janë dërguar për publikim në faqen zyrtare të internetit të SHKP, në Web-in e Bashkisë dhe në tendat e publikimit para Bashkisë. Shpallja paraprake e fituesve është bërë më datë 11.02.2019 dhe më datë 22.02.2019 është zhvilluar testimi me shkrim. Procedura e ndjekur nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit është kryer konform ligjit për shërbimin civil.

Në lidhje me rastin e punonjësit \*\*\*\*\*, i cili nuk plotësonte kriterin e nivelit arsimor, që kërkon pozicioni i punës, konstatoj se detyra e lënë ngë Komisioneri është zbatuar plotësisht. Është anuluar akti i marrjes në punë të këtij punonjësi dhe i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës me institucionin në datën 16.01.2019. Po në këtë datë,

pozicioni i punës “Përgjegjës Sektori në Sektorin e Marrëdhënieve me Jashtë e Publikun dhe TIK” është publikuar si vend i lirë në përputhje me legjislacionin e shërbimit civil.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe akteve në dosjen e punonjësës \*\*\*\*\* , si dhe nga këqyrja e akteve që janë depozituar lidhur me një proces administrativ e gjyqësor, të nisur që në vitin 2008 (periudhë kur funksiononte Komisioni i Shërbimit Civil) dhe i cili ka përfunduar në vitin 2016, rezulton se punonjësës i është njohur statusi i nëpunësit civil, me ligjin e vjetër të shërbimit civil (dispozitat kalimtare).

Në momentin e deklarimit të statusit të punësimit, sipas ligjit të ri (26.02.2014), punonjësja në fjalë nuk ka qenë pjesë e listëprezencës së Bashkisë, për shkak të pezullimit nga detyra, e për këtë arsye nuk i është deklaruar statusi në afatin e caktuar (viti 2014).

Vendimet gjyqësore kanë marrë formë të prerë në vitin 2016, e në këto kushte punonjësja rezulton nëpunëse civile për shkak të vendimeve të KSHC dhe Gjykatës Administrative. Në këto kushte, njësia përgjegjëse ka përpiluar një akt administrativ, në të cilin pasqyrohen shkurtimisht rrethanat specifike dhe akti i deklarimit të statusit me nr.176/1.prot., datë 16.01.2019.

Konstatohet se, punonjësja \*\*\*\*\* , e cila ka qenë në pozicionin e punës “Inspektore finance në sektorin e Menaxhimit Financiar”, në Drejtorinë e Menaxhimit Financiar, Buxhetit dhe Supervizionit” dhe sipas detyrave të lëna nga Komisioneri, duke vlerësuar edhe përvojën e gjatë të punës, është sistemuar në një pozicion tjetër pune që nuk është pjesë e shërbimit civil, konkretisht në pozicionin "Llogaritare në Drejtorinë e Menaxhimit Financiar dhe Buxhetit", nëpërmjet aktit me nr.213 prot., datë 17.01.2019.

Duke vlerësuar punën e njësisë përgjegjëse në këtë institucion, si dhe nga gjithë sa u analizua më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të administruar gjatë procesit të verifikimit, arrij në konkluzionin se nga ana e institucionit janë zbatuar drejt detyrimet e lëna në vendimin paralajmërues të Komisionerit.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

## **VENDOSA:**

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 89, datë 13.11.2018, *"Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në njësinë e vetëqeverisjes vendore, Bashkia Mirditë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë"*.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësisë përgjegjëse të institucionit të Bashkisë Mirditë, duke zbatuar rekomandimet e Vendimit Nr.89, datë 13.11.2018.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni i Bashkisë Mirditë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**